



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
POSTA SHQIPTARE SH.A  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
DREJTORIA LIGJORE

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

**Datë 06.09.2024**

**Drejtuar:** Operatori ekonomik “**Helius Systems**” me Nipt K91607030D  
Me adresë: Rruga Dritan Hoxha, Pallatet Komfort, Kulla Horizontale, Kati 11. Tiranë

**Procedura e prokurimit:** “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”

**Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-07033-05-29-2024**

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** “Mirëmbajtje të sistemeve Eterna dhe komponentëve të saj për 2 (dy) vite”, me fond limit **50,000,000 (pesëdhjetë milion)** lekë pa TVSH.  
Afati i ofrimit të këtij shërbimi është 24 (njëzet e katër) muaj nga data e lidhje së kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike datë 03.06.2024, nr. 29

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim  X

Me anë të kësaj, ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “**MC Networking**” me Nipt K72223007O me vlere të ofertës 42.501.000 (dyzet e dy milion e pesëqind e një mijë) lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik “**Helius Systems**” me Nipt K91607030D me vlere të ofertës 50.000.000 (pesëdhjetë milion) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik “**Advance Bussines Solutions - ABS**” me Nipt K21710002J, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe asnjë dokument tekniko ligjor.

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

Në datën 20.08.2024 komisioni i vlerësimit të ofertave i bëri kërkesë në sistemin elektronik të APP-së si dhe në rrugë postare operatorëve ekonomik “Helius System” sh.p.k. me shkresën Nr.1710 prot., datë 20.08.2024 dhe “MC Networking” sh.p.k. me shkresën Nr.1716 prot., datë 20.08.2024, se sipas pikës 2.3.4. të DST-së shtojca 8 (modifikuar) gjatë fazës së vlerësimit të ofertave duhet të demonstrojë realizimin me sukses të disa detyrave për mirëmbajtjen e sistemit Eterna pjesë e Kriterëve të veçanta për kualifikim të dokumentave standarte të tenderit, që do ti vendoset në dizpozicion nga KVO-ja.

*Për sa më sipër, jeni të lutur të paraqiteni pranë Autoritetit Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a., Adr.: Rr. “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë, për të realizuar testimin e kriterit për përmbushjen e tij. Testimet do të realizohen në ambientet e “Postës Shqiptare” dhe me burimet që “Posta Shqiptare” ka në dispozicion për të realizuar këtë procedure. Detyrat e testimit do tju bëhen të ditura në momentin që do të paraqiteni pranë ambienteve tona, brenda 3 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.*

Në datën 22.08.2024 operatori “Helius System” sh.p.k. nëpërmjet sistemit elektronik të APP-së ka depozituar një kthim përgjigje ku na është bërë e ditur se do të vijojnë me demonstrimin dhe realizimin e detyrave për mirëmbajtjen e sistemit Eterna pjesë e Specifikimeve Teknike të Shtojca 8, të DST-së, që do ti vendoset në dizpozicion nga KVO-ja, referuar pikës 2.3.4. të DST-së. Po në datën 22.08.2024 operatori “Helius System” sh.p.k. u paraqit pranë zyrave të “Posta Shqiptare” Sh.a. për te marrë në dorëzim dokumentacionin me detyrat që janë ngarkuar nga KVO-ja për realizimin e testimit për mirëmbajtjen e sistemit Eterna.Me shkresën Nr.110/20 prot., datë 22.08.2024 u caktua që demonstrimi dhe realizimi i këtyre detyrave të mbahet pranë ambienteve të “Posta Shqiptare” Sh.a. brenda datës 27.08.2024. Më datë 26.08.2024, në prani të përfaqësuesve të kompanisë Helius System sh.p.k., dhe anëtarëve të KVO, u bë testimi i detyrave të lëna nga procesverbali i datës 22.08.2024,ku dhe u mbajt procesverbali Nr.110/21 prot., datë 26.08.2024, proces i cili përfundoi në realizimin me sukses të detyrave të ngarkuara nga KVO.

Operatori ekonomik “MC Networking” sh.p.k. nuk ju përgjigj kërkesës për realizim të detyrave të KVO-së as në mënyrë elektronike dhe as në mënyrë postare. Duke qenë përpara faktit se ky operator nuk përmbush plotësisht kriteret ligjore dhe teknike për kualifikim, operatori ekonomik “MC Networking” sh.p.k. u skualifikua nga KVO-ja.

1. Operatori ekonomik “**Advance Bussines Solutions - ABS**” me Nipt K21710002J, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe asnjë dokument tekniko ligjor.

2. Operatori ekonomik “**MC Networking**” me Nipt K72223007O.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të ofertës së paraqitur në tender rezulton operatori nuk përmbush plotësisht kriteret ligjore dhe teknike për kualifikim,*Pika 2.3.4 shtojca 8 ‘Kriteri sipas DST në pikën 2.3.4. thotë qe Operatori ekonomik gjatë fazës së vlerësimit të ofertave duhet të demonstrojë realizimin me sukses të disa detyrave për mirëmbajtjen e sistemit Eterna pjesë e Specifikimeve Teknike të Shtojca 5, të DST-së’*,operatori ekonomik “MC Networking” sh.p.k

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se operatori ekonomik “**Helius Systems**” me Nipt K91607030D, me adresë: Rruga Dritan Hoxha, Pallatet Komfort, Kulla Horizontale, Kati 11. Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej 50.000.000 (pesëdhjetë milion) lekë pa TVSH., është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Ardit Demiri**